

Mariel Halilaj

Z. Mariel Halilaj ka kryer studimet e larta në Universitetin Teknologjik “Ismail Qemali”, Vlorë, Fakulteti i Tregtisë, Dega Biznes, ku është diplomuar si “Menaxher Biznesi, Profili Marketing”. Ka kryer Kurs Pasuniversitar për “Administrimin Publik”, i mundësuar nga Universiteti Teknologjik “Ismail Qemali”, Vlorë, në bashkëpunim me Universitetin e Roskildit, Danimarkë, CEFAL Bolonjë dhe Universitetin e Bolonjës, Itali. MBA – Master në Menaxhim Biznesi, Institucioni i Arsimit të Lartë “ISSAT”, Tiranë.

Z. Halilaj vjen nga një eksperiencë e gjatë pune, në nivel rajonal dhe kombëtar, si në sektorin privat ashtu edhe në pozicione drejtuese në administratën publike, si: Drejtor Rajonal i Entit Kombëtar të Banesave në Vlorë; Oficer Kredie, Zyra Rajonale e “Fondi BESA” sh.a., Vlorë; Specialist i Zyrës së Shpërndarjes në shoqërinë “La Petrolifera Italo-Albanese”, Vlorë; Drejtor Rajonal i Zhvillimit të Biznesit, “NOA” sh.a., Vlorë; Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit dhe Zhvillimit Rajonal në Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë; Përgjegjës i Sektorit të Kimikateve, Zhurmave dhe Aksidenteve Industriale në Ministrinë e Mjedisit; Përgjegjës i Sektorit të Projekteve në Agjencinë Kombëtare të Turizmit; Përgjegjës i Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve të Zhvillimit Turistik në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve; Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Marrëdhënieve të Punës, Sigurisë dhe Shëndetit, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Krahas përvojës menaxhuese të krijuar gjatë ushtrimit të detyrave të shumta, z. Halilaj ka qenë Këshilltar në Këshillin e Bashkisë Vlorë, njëkohësisht “Anëtar i Komisionit për problemet e shërbimeve dhe të strehimit”, si dhe ka marrë pjesë në shumë konferenca dhe seminare ndërkombëtare, në fushat e administrimit publik, sektorit financiar, turizmit, emergjencave, marrëdhënieve të punës, sigurisë dhe shëndetit, etj.